



O djalosh! Thuaj: "Bismilah", ha me të djathtën dhe ha pranë vetes!

Omer ibën Ebi Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Isha djalosh i vogël nën përkujdesjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Teksa hanim, dora ime shkonte andej-këndej nëpër pjatë. I Dërguari i Allahut ﷺ më tha: "O djalosh! Thuaj: "Bismilah", ha me të djathtën dhe ha pranë vetes!" Që nga ai çast, vazhdimisht veproj ashtu gjatë ngrënies."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Omer ibën Ebi Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ishte i biri i gruas së Profetit ﷺ, Umu Selemes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), dhe jetonte nën edukimin dhe përkujdesjen e tij, tregon se gjatë ngrënies i lëvizte duart nëpër të gjithë pjatën për të marrë ushqim andej-këndej. Prandaj, Profeti ﷺ ia mësoi atij këto tri rregulla të edukatës së të ngrënit: 1. Përmendja e emrit të Allahut, me "bismilah", në fillim të ngrënies. 2. Ngrënia me dorën e djathtë. 3. Të hahet nga ajo anë e ushqimit që është më afër tij.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/58120>

